

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – Departamenti për Krime të Rënda, kryetari i trupit gjykues-gjyqtari Beqir Kalludra, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores Mybera Latifi, procesmbajtëse, në lëndën penale kundër të akuzuarit F. M., nga fshati L. P., komuna e P., për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore e Prishtinës-departamenti për Krime të Rënda, PP/I.nr.224/15 të dt.29.07.2016, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit fillestar me dt.27.09.2016, në të cilën kanë prezentuar prokurori i shtetit Ilaz Beqiri dhe i akuzuari, të njëjtën ditë mori dhe shpalli publikisht:

A K T G J Y K I M

I akuzuari F. M., i biri i I. dhe A., e gjinisë P., i lindur me dt. *data e lindjes...*, në fshatin L. P., komuna e P., ku edhe jeton, me nr.të letërnjoftimit me nr. *numri i letërnjoftimit...*ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse

Që nga dt.23.02.2015 ka mbajt në pronësi dhe posedim dy pushkë gjuetie, dhe atë njëra pushkë dytytëshe, të prodhimit turk, me nr.serik 149867, si dhe pushka tjetër e tipit BOLD ACTION, prodhim spanjoll, e kal.7.92mm, me nr.serik 2049022, me ç'rast të njëjtave ju kishte skaduar leja përkatëse që nga dt.27.08.2012.

-me këtë ka kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së.

Prandaj gjykata konform dispozitave 2, 4, 50, 51, 52, 73, 74 dhe 374 par.1 dhe 3 të KPRK-së si dhe nenit 359, 365, 366, 368, 450, 453 të KPPRK, e:

G J Y K O N

ME DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në periudhën kohore prej 1 (një) viti, i akuzuari nuk kryen vepër tjetër penale.

Detyrohet i akuzuari që t'i paguaj shpenzimet e procedurës penale, aq sa do të jenë sipas llogarisë përfundimtare të kësaj Gjykate, ndërsa shpenzimet në emër të paushallit gjyqësorë, shumën prej 20 (njëzetë) €, brenda afatit prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Të akuzuarit i konfiskohen dy pushkë gjuetie, dytytëshe, të prodhimit turk, me nr.serik 149867, si dhe pushka tjetër e tipit BOLD ACTION, prodhim spanjoll, e kal.7.92mm, me nr.serik 2049022, të cilat janë sekuestruar nga ana e policisë, si mjet i kryerjes së veprës penale, dhe të njëjtat të shkatërrohen pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda, ka paraqitur aktakuzë PP/I.nr.224/15 të dt.29.07.2016, kundër të akuzuarit F. M., për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll, posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armës nga neni 374 par.1 të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale, Gjykata ka caktuar seancën e shqyrtimit fillestar, me dt.27.09.2016, dhe pas leximit të aktakuzës, i akuzuari, e ka pranuar në tërësi fajësinë për kryerjen e kësaj vepre penale me të cilën është akuzuar. Prokurori i shtetit nuk ka pas vërejtje në deklaratën e të akuzuarit për pranimin e fajësisë.

Meqë i akuzuari e ka pranuar fajësinë në tërësi për kryerjen e veprës penale si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë për kryerjen e veprës penale, pranim i cili është bërë vullnetarisht, pranim i cili mbështetet në faktet e çështjes dhe provat materiale që përmban aktakuza, dhe se nuk përmban asnjë shkelje ligjore apo gabim faktik, Gjykata vlerësoj se janë përmbushur të gjitha kërkesat ligjore nga neni 248 të KPRK-së, që të pranohet deklarata e të akuzuarit për pranimin e fajësisë për kryerjen e kësaj vepre penale, dhe të njëjtën edhe e ka aprovuar, duke mos administruar asnjë provë lidhur me vërtetësinë e gjendjes faktike.

Ashtu që, bazuar në një gjendje të tillë të pa kontestuar të fakteve, gjykata vërtetojë se në veprimet e të akuzuarit F. M., manifestohen të gjitha elementet qenësore të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll, posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, ashtu që të akuzuarin edhe e shpalli fajtor, dhe ia shqiptoj sanksionin penal përkatës, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Prokurori i shtetit në fund ka deklaruar se meqë i akuzuari e ka pranuar fajësinë, i ka propozuar gjykatës, që me rastin e vendosjes për llojin dhe lartësinë e sanksionit penal, që ta merr parasysh pranimin e fajësisë në të gjitha fazat e zhvillimit të kësaj procedure penale dhe gjendjen e rëndë ekonomike, ashtu që këto rrethana ti vlerësoj si rrethana lehtësuese.

I akuzuari i ka propozuar gjykatës që me rastin e shqiptimit të llojit dhe lartësisë të sanksionit penal, si rrethana lehtësuese ti vlerësoj pranimin e fajësisë në të gjitha fazat e zhvillimit të kësaj procedure penale, pendimin e të akuzuarit për këtë vepër, premtimin se i njëjti nuk do ti përsërit këto veprime në të ardhmen, si dhe faktin se asnjëherë më parë nuk ka qenë i gjykuar dhe në fund e ka lutur gjykatën që të njëjtit t'ia shqiptoj një sanksion sa më të butë të mundshëm penal.

Gjykata me rastin e matjes dhe përcaktimit të lartësisë dhe llojit të sanksionit penal për të akuzuarin, i vlerësoi të gjitha rrethanat relevante rënduese dhe lehtësuese, në kuptim të nenit 74 të KPRK-së, si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin vlerësoi faktin se i njëjti e ka pranuar fajësinë në mënyrë shumë të sqartë që nga fillimi i kësaj procedure penale, sjelljen dhe qëndrimin e tij shumë korrekt në gjykatë, se kjo gjykatë nuk ka të dhëna se i njëjti ka qenë i gjykuar më parë, pendimi i thellë i tij për këtë vepër penale, premtimi i të njëjtit se në të ardhmen nuk do ti përsëris asnjëherë këto veprime, moshën relativisht të shtyrë, e në mungesë të rrethanave rënduese, të akuzuarit ia shqiptojë sanksionin penal përkatës si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindje se një sanksion i tillë penal, është

në përputhshmëri të plotë me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të kësaj veprë penale dhe përgjegjësisë penale të të akuzuarit, dhe se dënimi i shqiptuar do të ndikojë në riedukimin, risocializimin dhe parandalimin e të akuzuarit dhe personave tjerë nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, me çka edhe do të arrihet qëllimi i përgjithshëm dhe i veçantë i dënimit konform nenit 50 të KPPK-së.

Vendimi lidhur me shpenzimet e procedurës penale kundër të akuzuarit, do të merret në bazë të llogarisë përfundimtare të kësaj gjykate, ndërkaq shpenzimet në emër të paushallit gjyqësor janë marrë, duke pasur për bazë ndërlikueshmërinë e veprës penale, kohëzgjatjen e zhvillimit të procedurës penale si dhe gjendjen pasurore të të akuzuarit, konform nenit 450 par.3 të KPRK-së.

Vendimi lidhur me konfiskimin e dy pushkëve gjuetie është marrë konform nenit 374 par.3 të KPRK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë, e në pajtim me dispozitat ligjore nga neni 365 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti për Krime të Rënda
PKR.nr.452/16, dt.27.09.2016

Procesmbajtësja
Mybera Latifi

Kryetari i trupit gjykues - gjyqtari
Beqir Kalludra

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa
Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afat prej 15 ditëve
nga dita e marrjes së të njëjtit, e përmes kësaj gjykate.